



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2867 / Prot.
3

Rrëshen më, 06 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 66 datë 01. 08. 2025

PËR

**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA “QAFMOLLË 03190049”, NË RRUGA
“NDUE PRENG KOLA 03190049”, FSHATI NDËRFUSHAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2, të nenit nr. 11, të ligjit nr. Nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2867 prot, datë 17.07.2025, të disa anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Mirditë, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Kulturës, Trashëgëmisë Kulturore, Dhënies Titujve, Emërtimeve për t’a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;*

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e emërimit të rrugës nga rruga “QAFMOLLË 03190049”, në rruga “NDUE PRENG KOLA 03190049”, fshati Ndërfushas, njësia administrative Rrëshen, kodi postal 4602, Bashkia Mirditë.
 - Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 5, 000.
 - Rruga fillon nga degëzimi i rr. fshatit Bukëmirë, “tek kthesa te diga e liqenit” dhe përfundon te banesa nr. 18.
 - Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 1224 mL, me gjerësi kaluese 5 Ml.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.

3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
4. Ngarkohet, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar!


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2867 / 2 Prot.

Rrëshen më, 22.07 . 2025

P / V E N D I M

Nr. 67 datë 22 / 07 / 2025

P Ë R

**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA "QAFMOLLE 03190049" NË RRUGA
"NDUE PRENG KOLA 03190049", FSHATI NDËRFUSHAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", pika 1/1.7. shkronja "b" e nenit 54, shkronja "ll" e nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (të ndryshuar), shkronja "dh" të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2867 prot, datë 17.07.2025 të disa anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Mirditë, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e emërimit të rrugës nga rruga "QAFMOLLE 03190049", në rruga "NDUE PRENG KOLA 03190049", fshati Ndërfushas, Njësia Administrative Rrëshen, kodi postal 4602, Bashkia Mirditë.
Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 5, 000.
Rruga fillon nga degëzimi i rr. fshatit Bukëmirë [tek kthesa te diga e liqenit" dhe përfundon te banesa nr. 18.
Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 1224 mL, me gjerësi kaluese 5 Ml.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1 të këtij vendimi shfuqizohet.

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

SEKRETARI

Gaspar TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHAJ

Drejtoria Juridik/Prokurimeve:

Majlinda TOPOLLAJ

KRYETARI

Albert MELYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2867/1 Prot.

Rrëshen më, 22 07 . 2025

RELACION I P/VENDIMIT “NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “QAFMOLLE 03190049” NË RRUGA “NDUE PRENG KOLA 03190049”, FSHATI NDËRFUSHAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4602, BASHKIA MIRDITË.

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit bashkiak Mirditë!

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2867 prot, datë 17 /07/2025 të disa anëtarëve të Këshillit bashkiak, parashtrijmë para Jush relacionin për miratimin e P/Vendimit të sipërcituar. **Rruga fillon nga degëzimi i rr. fshatit Bukëmirë [tek kthesa te diga e liqenit] dhe përfundon te banesa nr. 18.**
Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 1224 mL, me gjerësi kaluese prej 5.0 mL.



Bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, gjeni:

1. *Planvendosjen e rrugës;*
2. *Kërkesën e anëtarëve të Këshillit bashkiak;*
3. *Promemorjen e hartuar nga _____;*

Me respekt,

Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHA

Drejtorja Juridik/Prokurimeve:

Majlinda TOPOLLAJ

KRYETARI

Albert MËLYSHI



Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Mirditë

Këshillit Bashkiak Mirditë

I nderuar Kryetar i Bashkisë !

Të nderuar Anëtarë të Këshillit bashkiak !

Në cilësinë e një pjesë të anëtarëve të këshillit bashkiak Mirditë, për arsye
_____ kërkojmë nga ana Juaj emërtimin e rrugës në territorin
të bashkisë Mirditë të emërtohen si vijon:

1. Rruga "Qafmollë 03190049" të ndryshohet në rruga "Ndue Preng Kola 03190049",
fshati Ndërfushas, 4602, Bashkia Mirditë.

Bashkëlidhur ju dërgojmë edhe 'Promemoriët' përkatëse.

Me respekt,

Anëtarët e këshillit bashkiak Mirditë

Emër

Mbiemër

Nënshkrimi

ALEKSANDER PICAKU

Marina Vorfi

Florenc Gjonaj

Leonard Dledaj

Mark Gjoka

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Nr. 2867 Prot
Dt. 17.07.25



PROMEMORJE

Ndue Preng KOLA

I ndjeri Ndue Preng Kola u lind në vitin 1959, në një familje të përsekutuar dhe numeroze me varfëri ekonomike.

Fëmijëria e tij i përkiste periudhes kur regjimi i ndante fëmijët në bij familjesh me biografi të mire dhe në bij e bija kulakesh, ndaj pat fatin e vështirë të kalonte një fëmijëri e rini nën diskriminim diktuar nga propaganda komuniste.

Simbol i urtësisë, plot kulturë dhe dëshirë për jetë.

Është për tu çmuar fakti se ka qënë shembull i respektit, njeri i vlerave qytetare, i shoqërueshëm dhe aktiv në nismat si familjare ashtu edhe shoqërore, model i krenarisë dhe shkëlqimit të njeriut të vuajtur si kundërpërgjigje e epiteteve të kulakut, epitete të cilat partia e punës u'a vishte qëllimisht djemve dhe vajzave të ardhur nga familje me biografi të keqe.

Pasioni i tij i parë ka qënë mekanika dhe mjetet levizëse ku vlen për tu përmendur se pas punësimit më tej veshtirësi në Parkun e Mallrave Mirditë, ka shkëlqyer edhe pse i sulmuar për biografi të keqe.

Me ardhjen e demokracisë është sistemuar në forcat e Rendit ku falë aftësive dhe vlerave të tija, ka shkëlqyer në fushën e komunikimit, ka ruajtur mrekullisht integritetin e një ushtaraku në mardhënie pune me shtetin.

Nëse shoqëria do të përbëhej vetëm nga të tillë, njerëz të moralshëm, të paqtë, të urtë dhe dinjitoz dhe të integrueshëm, shoqëria do të kishte prekur suksesin më të vecantë, ndaj le të mbetet si shembull kujtese, frymëzimi dhe integriteti!